



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 18, date 26/04/2004

**“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT  
TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME  
TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE”.**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” neni 32, gërma “ç”, ligjit Nr.8560, dt.22/12/1999 “Për procedurat tatimore” dhe udhëzimit në zbatim të këtij ligji, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.5, dt.27/02/2003 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.7, dt.07/03/2003 “Për sistemin e taksave vendore në qytetin e Tiranës” me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I;**

1. Të miratojë Rregulloren e Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të miratojë përshkrimin e punës për të gjitha strukturat e Drejtorisë në përputhje me Rregulloren.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**